



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008 dhe të nenit 36, paragrafi 36.1 i Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110 - 391, dt. 25.2.2010 dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/15 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

**th ë r r e t**

mbledhjen e **parë** të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, e cila do të mbahet më **15.02.2016** dhe do të fillojë në orën **14:00**.

Mbledhja do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, rr. "UÇK", nr. 61.

Për këtë mbledhje **p r o p o z o n** këtë

**REND DITE:**

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së nëntë të Kuvendit (2015) dhe të mbledhjes urgjente të Kuvendit (2016) ;
2. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues urban të lagjes "Mati 2";
3. Propozimvendimi për miratimin e plotësimit dhe ndryshimit të Planit rregullues urban të lagjes "Sofalia";
4. Propozimvendimi për lënien në dispozicion për diskutim publik të Planit rregullues urban të lagjes "Kodra e Trimave 1";
5. Propozimvendimi për dhënien e pëlqimit për ndryshime në infrastrukturë në një pjesë të Planit rregullues urban të lagjes "Lakërishta" në Prishtinë;
6. Propozimvendimi për rikategorizimin e parkut regional natyror "Gërmia" në kategorinë - Peizazh i mbrojtur "Gërmia";
7. Propozimrregullorja për organizimin e punës në shkolla fillore, të mesme të ulëta dhe të mesme të larta;
8. Propozimvendimi për konsulta paraprake publike lidhur me Rregulloren mbi taksat administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifrat për rregullimin e infrastrukturës;

**Vërejtje:** *Luteni që të merrni pjesë në mbledhje. Në rast pamundësie për të marrë pjesë, lajmërohuni në Shërbimin e Kuvendit, në tel. Kontaktues: 038/245-666 & 038/230-900, lok. 1100.*

9. Propozimvendimi për caktimin e komisionit për përzgjedhjen e kryetarëve të Bashkësive lokale;
10. Propozimvendimi për formimin e grupit punues për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores për bashkësi lokale;
11. Shqyrtimi i Raportit buxhetor për situatën ekonomiko-financiare të Komunës për periudhën janar - qershor 2015;
12. Shqyrtimi i Raportit buxhetor tremujor, korrik - shtator 2015;
13. Shqyrtimi i Raportit të auditimit për pasqyrat financiare të Komunës së Prishtinës për vitin e përfunduar, më 31 dhjetor 2014;
14. Propozimvendimi për dhënien në shfrytëzim pa pagesë të një pjese të SHML "Gjimnazi Matematikor" për Institutin ndërkombëtar për inteligjencë të jashtëzakonshme "Atomi";
15. Propozimvendimi për këmbimin e pronave të Komunës me prona private;
16. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve të komisionit për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2016;
17. Propozimplani lokal i veprimit për riintegrimin e personave të riatdhesuar;
18. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit për formimin e Komitetit për Komunitete;
19. Propozimvendimi për ndryshimin e vendimit për formimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
20. Pyetje dhe përgjigje;
21. Të ndryshme.

## **KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01. nr. 06 - 29065, më 04 - 02 - 2016**

**KRYESUESI I KUVENDIT**  
**Halim Halimi, jur. i dipl.**